

V E N D I M
Nr.63, datë 11.2.1999

**PËR EMBLEMËN E KAPELES, NDËRTIMIN E GRADAVE TË FORCAVE TË
MBROJTJES DETARE DHE STEMAT E STRUKTURAVE TË MINISTRISË SË
MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 2, 51 dhe 52 të ligjit nr.7978, datë 26.7.1995 “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 16 të ligjit nr.7750, datë 13.9.1993 “Për gradat në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 44 të ligjit nr.7810, datë 6.4.1994 “Për arsimin e lartë ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Emblema e kapeles për Forcat e Mbrojtjes Ajrore, Forcat e Mbrojtjes Detare, si dhe forma e ndërtimi i gradave për Forcat e Mbrojtjes Detare, të jenë sipas albumit, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Stemat e Akademisë së Mbrojtjes, Akademisë Ushtarake “Skënderbej” dhe Akademisë së nënoficerëve të jenë sipas albumit, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Stemat për Forcat e Armatosura Tokësore, Ajrore, Detare, për institucionet ushtarake, njësitë dhe repartet autonome etj. miratohen nga Ministri i Mbrojtjes.

4. Rregullat e përdorimit të stemave përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes.

5. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.642, datë 20.11.1995 “Për formën dhe ndërtimin e gradave në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, në pikën 1, pjesa e albumit të gradave për Forcat e Mbrojtjes Detare shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I
Pandeli Majko